

NJË DOKUMENT (BROSHURË) E RËNDËSISHME E LËVIZJES ILEGALE SHQIPTARE PËR DISKRIMINIMIN EKONOMIK NDAJ KOSOVËS NË ISH-JUGOSLLAVI (1987)



Prof.dr. Sabile Keçmezi-Basha

Ditë më parë duke hulumtuar në arkivin tim personal, gjeta një broshurë, që çuditërisht më kishte ikur nga mendja nga koha që kur e kam gjetur në arkivin e gjykatës së qarkut në Prishtinë. Në mesin e shumë materialeve në dosjen e Hydajet Hysenit, e gjeta edhe këtë. Broshura mban titullin “Eksplotimi i egër nën prangat e rënda kolonialiste”, botuar më 1987, nga biblioteka “Liria”, “Zëri i Kosovës”, c/o Buchandlung KB badhausstr.35, CH-2503 Biel/Bienne, Zvicër.

Tjera të dhëna nuk kam, nuk e dijtë shkrimet e kujt janë të botuara, megjithëse në të thuhej se këto shkrime janë botuar edhe më herët në vazhdim, në gazetatat e ilegales që botoheshin gjithandej nëpër botë. Edhe pse broshura u gjend në burg, për çudi, në të, nuk ka asgjë të shënuar, as për autorin apo autorët ndonjë të dhënë. Zakonisht, gjatë hulumtimeve kam hasur se në gazetatat apo në ndonjë dokument tjetër të marr nga të burgosurit politik nga ana e hetuesve të ndryshëm të organeve hetuese, ata, atë që kanë zbuluar, i kanë shënuar në dokument (siç e kamë hasur tek gazeta “Liri” dhe “Zëri i Kosovës”).

Broshura ka format të zakonshëm A5, dhe ka 75 faqe. I paraprin Parathënia dhe në vazhdim ka Hyrjen, dhe është e ndarë në bazë të temave që trajton si: Strategjia e politikës ekonomike; Struktura e rendit ekonomik e Kosovës; Vëllimi i pamjaftueshëm dhe struktura e rendit e investimeve; Fondi-lak në fytin e ekonomisë së Kosovës; Shpërndarja



primare; Shpërndarja sekondare; Çfarë akumulimi realizon ekonomia e Kosovës; Kriza e thellë ekonomike; Humbjet në ekonomi-dukuri të krizës së thellë; Mosrealizimi i planeve- pasojë e krizës; Papunësia- sëmundje e pashërueshme në shoqërinë jugosllave; Kurbeti- plagë e rëndë për shqiptarët; Detyrimet- diktat kolonialist; Humbjet ekonomike-barrë e

rëndë për punëtorët; Kushtet e vështira të punës rrezikojnë shëndetin dhe jetën e punëtorëve; Propaganda shoviniste e Beogradit nxit urrejtjen në mes punëtorëve; Vullkani i protestës dhe mbyllët me një përfundim të shkurtër por mjaftë të rëndësishëm për kohën.

Duke e lexuar materialin, lexuesi i zakonshëm do të mendojë se këtë material e ka shkruar ndonjë njohës i mirë i raporteve ekonomike në Jugosllavi, Serbi e Kosovë. Që në parathënie, na bëhet e njohur se kjo broshurë, (siç e ceka edhe më herët), është botuar në vazhdime në organin e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës “Zëri i Kosovës” e cila ngërthen një material të shtjelluar mbi baza shkencore dhe që ngërthen anën ekonomike të problemeve të ndryshme të cilat e kanë përfshirë ekonomin jugosllave dhe më këtë edhe shtimin e shtypjes dhe shfrytëzimin kolonialist të Kosovës¹, thuhej në parathënie.

Në vazhdim të materialit thuhej edhe kjo se “për të shtjelluar shkaqet dhe arsyet e vërteta të shpërthimit të demonstratave dhe revoltës masovike të vitit 1981 në Kosovë duhet medoemos të analizohen edhe rrethanat dhe kushtet ekonomike në të cilat gjendej Kosova dhe populli shqiptarë para vitit 1981. Sepse, njëra nga shkaqet kryesore e shpërthimit të një revolte gjithë popullore çfarë ishte shpërthimi i vitit 1981 në Kosovë nga pushteti serbomadhi i Beogradit²

Materiali i lëvizjes ilegale në një mënyrë dëshmon arsyen e shpërthimit të demonstratave studentore të vitit 1981, që tranden në themel shtetin e Jugosllavisë duke treguar se bazamenti i tërë kësaj ishte gjendja e mjeruar ekonomike në Kosovë e ndikuar dhe e ndihmuar nga pushteti okupues jugosllavë. Analizuesi i kësaj shtate thekson se duke pasur për qëllim analizimin e kushteve dhe rrethanave ekonomike në Kosovë para vitit 1981, ai me një përkushtim të madh ia ka arritur që shkencërisht të faktojë bazat mbi të cilat bazohet politika ekonomike e Beogradit ndaj ekonomisë së Kosovës, qëllimet e kësaj politike ishin veç të ditura, dimensionet e saja dhe përmasa alarmuese e pasojave të mundshme. Veç paraqitjes në mënyrë të argumentuar të diskriminimit të ekonomisë në Kosovë, autori i librit shkon edhe më tej duke bërë edhe propozimin për zgjidhjen e cila duhet ndjekur nga regjimi i Beogradit për të zhdukur këtë diskriminim ekonomik.

¹Eksplotimi i egër nën prangat e rënda kolonialiste , 1987, 3

²Po aty.

Duke u thelluar në leximin e broshurës, më habit e dhëna se autori është njohës i mirë i situatës ekonomike në botë duke i shtjelluar sistemet e ndryshme botërore politike dhe ndikimin e tyre në ekonomin globale. Në hyrje të librit që ka vetëm 3 faqe tekst, autori analizon ekonomin e Kosovës duke shtuar se :Kosova, siç dihet është vendi me pasuri të mëdha, si nëntoka e saj me minerale të çmueshme dhe mbi toka e saj shumë pjellore. Brendia e tokës së Kosovës përmban në sasi të mëdha thuaaja se të gjitha elementet e Sistemit të Mendeljevit si: plumb, zink, thëngjill, nikel, ari, argjend, magnezit, antimon, etj...etj...³ thuhej në tekst

Strategjia e politikës ekonomike

Në punimin “Strategjia e politikës ekonomike”, autori anonim analizon situatën politike që nga vitit 1945 e këndej, duke analizuar dendur padrejtësitë e shtypjet e shumta ndaj popullit shqiptarë. Pas vendosjes së pushtetit ushtarak e policor në Kosovë, qëllimi i okupuesit ishte copëtimi i tokave shqiptare në republikat e ish-Jugosllavisë si: në Maqedoni, Mal të Zi e Serbi. Pjesët tjera të cilat u okupuan nga Serbia mbetën jashtë Kosove. Copëtimi i tokave shqiptare në një mënyrë paraqitet një lehtësi më të madhe për okupuesit që t’i shtypnin më lehtë dhe t’i shfrytëzonin pasurit e tyre pa ndonjë problem.

Pasi pushteti jugosllav, legalizoi robërimin e këtyre trojeve me urgjencë u morën masat ushtarake, policore, legislative, politike, ekonomike dhe masat tjera shtetërore për të siguruar eksploatimin sa më të shpejt dhe sa më të egër të Kosovës. Në këtë mënyrë Kosovën e kthyen në një çiflig të Serbisë, ku do të mundeshin të shfrytëzonin pasuritë e saja si të donin e sa të donin, pa kurrfarë përkufizimesh. Kështu Kosova u kthye në një koloni nën qeverisjen e drejtpërdrejt të Serbisë.⁴ Në kushtet dhe rrethanat që u cekën më lartë, mund të themi se Qeveria e Beogradit dhe e Jugosllavisë përcaktoi strategjitë e shfrytëzimit barbar kolonialist të pasurive natyrore të Kosovës.

Dhe në bazë të kësaj që u tha më lartë mundemi të vijmë në përfundim se diskriminimi ekonomik që u bë në Kosovë i kishin rrënjët në padrejtësitë e pabarazitë tjera sociale, politike, shoqërore dhe kombëtare⁵, mendonte autori i shkrimit.

³ Hyrje, 7

⁴ Punimi: Strategjia e politikës ekonomike, 9

⁵ Po aty

Autori vazhdon më tutje se si çdo okupues e robërues, pas tërë kësaj padrejtësie në një mënyrë më fine mundohet që sjelljet e tija ti paraqet si “shpëtimtarë”, si “çlirimtare”. Po ashtu klika serbomadhe nuk kursen fjalë dhe fraza si: “marksizëm”, “socializëm”, “komunizëm”, “vëllazërim e bashkim”, “barazi”, “drejtësi”, “ndihmë”, “zhvillim i shpejt” etj, të cilat janë thellësisht antishqiptare dhe janë masa të ndyra të paturpësisë së saj. Dhe krejt në fund të punimit, autori në një mënyrë i bënë thirrje popullit shqiptarë, që këtë maskë të turpit të Serbisë e Jugosllavisë, populli shqiptarë duhet të çjerrë, ngase detyrë e çdo shqiptari patriot e të ndërgjegjshëm është që ta demaskojë deri në fund politikën antishqiptare e antikomuniste të qeverisë serbomadhe në të gjitha pikat e saja, e ne sigurisht që këto do të mund ta bëjmë, sepse realiteti dhe drejtësia është në anën tonë⁶ përfundohet punimi.

Në punimin “*Struktura e rëndë ekonomike e Kosovës*”, thuhej se duke pasur parasysh qëndrimin thellësisht armiqësor dhe antishqiptarë ndaj Kosovës, krerët e Beogradit i kanë marrë të gjitha masat (ushtarake, policore, politike etj...) që ekonomia e Kosovës të jetë vetëm një shtojcë e ekonomisë serbomadhe. Ekonomisë e sidomos industrisë së Serbisë i ishin shumë të nevojshme (ashtu si çdo ekonomi grabitëçare) burimet e sigurta të lëndëve të para, ndaj, angazhuan të gjitha forcat e saja për sigurimin e tyre. Nga presioni i kësaj ekonomie, ndaj ekonomisë së Kosovës u përcaktua se cilat degë të ekonomisë e cilat degë të industrisë të ngritën në Kosovë⁷. Pas këtyre trysnive ekonomike, në Kosovë u ngritën vetëm ato degë ekonomike dhe të industrisë të cilat siguronin lëndë të parë dhe materiale riprodhuese për industrinë përpunuese serbo-jugosllave.

Favorizimi i zhvillimit të industrisë bazike, si metalurgji me ngjyrë (xehet të plumbit dhe të zinkut, koncentratit i zinkut, koncentratit i plumbit, plumbi i pa përpunuar, plumbi i rafinuar, zinku elektrolit etj), prodhimi i arit, argjendit, industria e jometaleve (magneziti i papërpunuar, magneziti kaustik i pjekur, magneziti sinter etj), industri së thëngjillit dhe i industrisë së elektroindustrisë bënte që ekonomia e Kosovës ti ketë të zhvilluara vetëm ato degë të industrisë të cilat merren me nxjerrjen dhe përpunimin primar të mineraleve⁸. Për të vazhduar më tej se zhvillimi i degëve bazike siç ishte ai i deri i atëhershmi ishte me

⁶ Po atz, 10

⁷ Struktura e rëndë ekonomike e Kosovës, 11

⁸ Po aty, 12

pasoja katastrofale për Kosovën. Dihet se pasurit minerare ishin të papërsëritshme dhe nëse vazhdohej kështu eksploatimi sistematik dhe intensiv i këtyre pasurive, do të vijë koha kur edhe do të shteren ato⁹. Andaj edhe brohoritja e parullës nga studentët në demonstrata e vitit 1981, “Trepça punon, Beogradi ndërtohet”, nuk ka qenë parullë e rastësishme e thirrur nga ata, ajo ka qenë shprehje e thellë e pakënaqësisë dhe e protestës së shqiptarëve kundër eksploatimit të Kosovës.

Në punimin *“Vëllimi i pamjaftueshëm dhe struktura e rëndë e investimeve”*, autori bënë një analizë të thukët për situatën dhe investimet ekonomike në Kosovë para vitit 1981. Dihet se për të bërë investime diku në republika apo në krahina në Jugosllavi vendoste klika pushtuese e Jugosllavisë. Andaj, politika e Beogradit mbi investimet në Kosovë ka qenë dhe ishte që në Kosovë të investohet aq sa të sigurohen lëndët e para dhe materiali riprodhues me sasi të mjaftueshme për ekonomin e Serbisë (kryesisht) dhe asaj të Jugosllavisë si dhe të sigurohet minimumi i ekzistencës, apo më mirë të themi, shkalla më e ulët e jetesës të banorëve të kësaj treve¹⁰. Në vazhdim, autori thotë se politika e investimeve shoviniste kishte dy qëllime kryesore, që dukeshin kontradiktore: së pari që sa më pak të investohet në objektet ekonomike kosovare që të sigurojnë sa më shumë lëndë të parë për ekonominë serbo-jugosllave. Synimi i parë ka të bëjë me tendencën që sa më pak të investohet në Kosovë, kurse i dyti ka të bëjë me strukturën e investimeve¹¹.

Për të argumentuar padrejtësitë e shumta në Jugosllavi e Serbi që ishin bërë ndaj Kosovës, autori na sjell statistika të cilat dëshmojnë katërçipërisht për okupimin jugosllav ndaj Kosovës. Po sjellim të dhënat ashtu siç i ka paraqitur autori në broshurë, për të treguar se sa është investuar në Kosovë, në krahasim me investimet në Jugosllavi, po shënojmë lëvizjet e investimeve ekonomike për një banor. Pjesëmarrja e investimeve ekonomike për një banor të Kosovës në investimet ekonomike të mesatares jugosllave më 1947 ishte 51.2 për qind, më 1953, ishte 24.2 për qind, më 1970, 45.6 për qind, më 1981 5,0 për qind. Dhe nga këto të dhëna vijmë në përfundim se për çdo vit që ka kaluar në Jugosllavi investimet në Kosovë vijën duke u zvogëluar dukshëm. Nga këto fakte del se investimet ekonomike as për së afërmi nuk përkojnë me nevojën e

⁹ Po aty, 13

¹⁰Vëllimi i pamjaftueshëm dhe struktura e rëndë e investimeve, 16

¹¹ Po aty, 18

madhe për përmirësimin e bazës materiale të Kosovës. Ky diskriminim sigurisht se kishte pasoja të mëdha në zhvillimin e gjithmbarshme të Kosovës¹².

Duhet pas parasysh se ekonomia e Kosovës nuk kishte aftësi të mjaftueshme për vetëfinancim, e më këtë nuk kishte mundësi as për të bërë financime nga burimet e veta. Pra 90.1 për qind të investimeve ekonomike në Kosovë kanë qenë nga kreditë jashtë Kosove. Në këto marrëdhënie kreditore fjalën kryesore e kishin kredi dhënësit. Pastaj, këto kredi siguroheshin ekskluzivisht nëpër mes kërkesës që i bënë strukturat politike të Kosovës, struktura politike e Serbisë dhe e Jugosllavisë. Ata të Beogradit e të tjerët nuk i japin që Kosova të investojë ku të dojë, por ato kredi jepen vetëm ku shkojnë në interes të tyre¹³, thuhej në këtë analizë ekonomike e financiare.

Në vazhdim të punimit "*Fondi-lak në fytin e ekonomisë së Kosovës*", autori trajton masat eksploatore të shtetit jugosllav ndaj Kosovës. Më 1963, siç dihej me kushtetutën jugosllave u institucionalizua themelimi i Fondit për zhvillimin më të shpejt të viseve të pazhvilluara. Mjetet e këtij fondi, në atë kohë kishin një titull pompoz siguroheshin me anë të ligjit nga të gjitha republikat dhe krahinat. Mjetet e këtij fondi pastaj duhet të ndaheshin në formë të kredisë në kamata në mes të republikave jo mjaftë të zhvilluara dhe të Kosovës së pazhvilluar. Autori i shkrimit kërkon që është me rëndësi për Kosovën, që të çjerrët maska e eksploatoreve të këtij fondi, për të nxjerr në shesh "ndihmën" që i jepet Kosovës.

Duke e ditur mos aftësinë vetë financuese të ekonomisë së Kosovës, me këtë edhe mos sigurimin e lëndëve të para për ekonomin jugosllave, shovinistet grabitëçar themeluan këtë Fond, si mënyrë të plasimit të kapitalit të tyre në ekonomin në fjalë. Me këtë, këta mendonin (ashtu edhe u bë) që ekonomia e Kosovës të bëhej plotësisht e varur nga kredit e këtij Fondi, si dhe të jenë në gjendje më mirë t'i dirigjojnë destinimet e investimeve për në degët ekstraktive të industrisë.¹⁴ Duke analizuar punimin në fjalë lexuesi i zakonshëm vije në përfundim, se në shtetin e Jugosllavisë dhe nën kthetrat e Serbisë okupatore, ama bash asgjë nuk iu ka mbet rastit. Çdo gjë është planifikuar, është punuar dhe në fund është

¹² Po aty, 18

¹³ Po aty, 19

¹⁴ Fondi-lak në fytin e ekonomisë së Kosovës, 20-21

futur në sistem për tu bë legjitimimi i padrejtësive ndaj Kosovës dhe popullit shqiptarë.

“Shpërndarja primare”, është punimi në vazhdim, ku në mënyrë të detajuar bëhet analiza e shpërndarjes primare e ekonomisë në Jugosllavi, Serbi e Kosovë, duke vu në pah të gjitha diskriminimet që iu bënë Kosovës në vazhdimësi. Veprimi i instrumenteve dhe i masave të sistemit ekonomik, si dhe politika ekonomike në mënyrë të drejtpërdrejtë përcaktojnë pozitën ekonomike të çdo ekonomie republikane e krahinore. Si në çdo ekonomi, edhe në Kosovë ishte me interes të madh roli i sistemit dhe politikës së çmimeve (politika ekonomike e Jugosllavisë) në eksploatimin e egër të Kosovës. Sistemi i çmimeve në ish Jugosllavi nuk ishte sistem autonom, por se ai varej nga rendi dhe politika ekonomike. Me rëndësi ishte edhe se çfarë vendi zënë ekonominë e republikave dhe krahinave, varësisht nga strukturat e tyre ekonomike. Ato ekonomi që janë në gjendje të volitshme të strukturës ekonomike kanë edhe pozitë të privilegjuar në sistemin e çmimeve.¹⁵ Se çfarë strukture ekonomike kishte ekonomia e Kosovës, ajo ishte e ditur, e mjerueshme. Andaj, duke u nisur nga kjo gjendje mund të përcaktojmë se ekonomia e Kosovës ishte në kushte të jashtëzakonshme të disfavorshme ndaj këtij sistemi. Sistemi i çmimeve përcaktonte se cilat degë ekonomike apo industriale do të kenë çmime të cilat formoheshin pak a shumë në mënyrë të pavarur dhe cilat degë do të jenë nën çmim rreptësisht të dirigjuara nga federata jugosllave. Andaj, pyet autori, se çfarë do të thotë dirigjim serbo-jugosllav për Kosovën?¹⁶ Dhe po i njëjti autor vet përgjigjet se ai do të thotë eksploatim i egër, urrejtje e thellë antishqiptare, pabarazi e padrejtësi në çdo aspekt.¹⁷ Nëpër mes çmimeve pranohet një vlerë e caktuar e një produkti, por zakonisht këto çmime nuk janë të barabarta me vlerën reale. Pra, po ekzistua mundësia pa kurrfarë dyshimi që dikush të humbë dhe dikush të fitojë me anë të çmimeve. Nga kjo del se nëpërmjet çmimeve po u bëka një shpërndarje primare. Shpërndarja primare paraqet mënyrën dhe metodën më drastike të eksploatimit të egër të Kosovës.

Çmime jo ekonomike dhe jo akumulative në Kosovë aplikoheshin në çdo sektor të mundshëm. Çmimet e energjisë elektrike të kombinatit “Kosova” jo vetëm që ishin të pabarabarta me çmimet e degëve tjera të

¹⁵ Shpërndarja primare, 24

¹⁶ Po aty, 25

¹⁷ Po aty

industrisë por ato ishin edhe shumë më të ulëta në krahasim me çmimet mesatare të energjisë elektrike në Jugosllavi. Gjithashtu edhe në kombinatin “Trepça”, që kishte rëndësi të veçanta për Kosovën, ndodhte i njëjti diskriminim në çmime. Çmimet e tërë prodhimit e këtij kombinati ishin nën kontrollin e rreptë të Serbisë, dhe në këtë mënyrë bëhej e mundshme derdhja apo më mirë të themi plaçkitja e të ardhurave të krijuara me mundin, djersën dhe gjakun e punëtorëve të “Trepçës”. Dhe sado që ishte i madh puna dhe munda i punëtorëve, rezultatet e tyre nuk vareshin nga puna e tyre por nga pozita e “Trepçës” në sistemin e çmimeve. Kjo statistikë e pabarazisë vlen për të gjitha organizatat që punonin në Kosovë. Si rrjedhojë e krejt kësaj del se çmimet në Jugosllavi nuk ishin shprehje e kushteve të barabarta të aktivitetit ekonomik të organizatave ekonomike apo të ekonomive republikane e krahinore, porse ato ishin shprehje e shpërndarjes primare, pasoj e së cilës ishin rezultatet e modifikuara apo më mirë të themi të diskriminuara¹⁸

“Shpërndarja sekondare” është punimi në vazhdim që tërheq vëmendjen e autorit. Sikurse shpërndarja primare gjithashtu edhe shpërndarja sekondare kishte efekte negative për ekonomin e Kosovës. Me instrumentet e shpërndarjes sekondare si tatimet, kontributet dhe obligimet ligjore etj, të gjitha këto grumbulloheshin në buxhetin federativ mjete të mëdha për nevoja të përgjithshme dhe të përbashkëta¹⁹, thekson autori.

Kështu në bazë të të dhënave zyrtare, pjesëmarrja e mjeteve për nevoja të përgjithshme dhe të përbashkëta (jugosllave) nga të ardhurat e realizuara të Kosovës për shembull në vitin 1973 ka qenë 39.7 %, kurse nga të ardhurat e tyre të realizuara Bosnja e Hercegovina ka ndarë 35.3%. Një gjendje përafërsisht e njëjtë është edhe në vitin 1978, kur mjete të tilla Kosova ka ndarë 38.6% kurse Jugosllavia 35% (nga të ardhurat e realizuara). Se çfarë peshe të rënd kishin këto përqindje për ekonomin e Kosovës do të tregojnë statistikatat zyrtare sipas llogarive të vitit 1978, kjo ekonomi realizon mjete që mund të shërbejnë për riprodhimin (akumulimin) vetëm 2.7 miliard dinarë të rinj (prej të cilave 2.2 miliardë përbejnë mjete të amortizimit të obligueshëm), kurse në emër të obligimeve për nevoja të përgjithshme jugosllave pagoi 4.4 miliardë

¹⁸ Po aty, 28

¹⁹ Shpërndarja sekondare, 29

dinarë të rinj²⁰. Kur të jenë obligimet e republikave ose krahinave në Jugosllavi për nevoja të përgjithshme për 1.7 herë më të mëdha se akumulimi, siç është rasti i Kosovës, e këtë nuk mund të mos e quajmë katastrofë të vërtet ekonomike. Kjo katastrofë ekonomike e Kosovës është pasojë e eksploatimit të pamëshirshëm, i cili bëhet edhe me këtë mënyrë (shpërndarja sekondare) nga ana e Serbisë dhe Jugosllavisë në tërësi²¹, përfundon autori i shkrimit.

Në vazhdim të broshurës, autori apo autorët trajtojnë në mënyrë analitike akumulimin e ekonomisë së Kosovës, në vitet 1971-1974. Në punimin “Çfarë akumulimi realizon ekonomia e Kosovës”, për të vazhduar më tej autori se, ekonomia e Kosovës duke qenë në marrëdhënie kolonialiste dhe eksploatoreve me ekonomin e Jugosllavisë realizon normë shumë të ulët të akumulimit. Për shkak të mungesës së të dhënave statistikore mbi normat e akumulimit për vitet e fundit do të shërbehemi me të dhënat zyrtare për normat në fjalë për Jugosllavinë, Bosnjën e Hercegovinën, Maqedoninë dhe Kosovën për vitet 1971 dhe 1974:

	1971	1974
Ekonomia (shoqërore) gjithsejtë		
Jugosllavia	12.9	10.0
Bosnja e Hercegovina	10.3	9.0
Maqedonia	11.1	9.9
Kosova	6.7	5.7
Industria		
Jugosllavia	12.8	11.4
Bosna e Hercegovina	10.0	9.6
Maqedonia	9.7	11.4
Kosova	6.0	5.8

Siç shihet nga këto të dhëna norma e përgjithshme e akumulimit të Kosovës është për 1.9 herë më e ulët në krahasim me atë të Jugosllavisë në vitin 1971, kurse në vitin 1974, norma e akumulimit të ekonomisë së Kosovës gjithashtu është shumë më e ulët edhe se e republikave që

²⁰ Po aty, 30

²¹ Po aty, 30

merren si të pazhvilluara. Kështu në bazë të të dhënave na del se norma e akumulimit të ekonomisë së Kosovës është më e ulët se e asaj të Bosnjës e Hercegovinës për 1.6 herë dhe 1.7 herë ndaj normës së akumulimit të ekonomisë së Maqedonisë²², thuhej në shkrim.

Ndërsa norma e akumulimit në industri është më e ulët për dy herë në krahasim me normat e akumulimit të industrisë së Jugosllavisë e të Maqedonisë. Nga e tërë kjo që shihej në statistikat e akumulimit të përgjithshme në Kosovë ishte më e ulët se mesatarja jugosllave dhe të atyre të Bosnjës e Hercegovinës dhe të Maqedonisë. Për ta elaboruar më thjeshtë del se në çdo 100 dinar të angazhuar industria e Kosovës ka akumuluar prej 5.8 dinar, kurse ajo e Bosnjës e Hercegovinës dhe ato të Jugosllavisë e të Maqedonisë kanë nga 11.4 dinar. Pra fondet e organizatave ekonomike të Jugosllavisë janë rritur për 2 herë e gjysmë (2.5 herë), të Bosnjës e Hercegovinës 1.9 herë dhe të Maqedonisë për 2.4 herë më shumë se të atyre të Kosovës²³. Pra, ky akumulim kaq i vogël i ekonomisë së Kosovës është pasojë e strukturës së rëndë ekonomike të investimeve, të shpërndarjes primare (sistemi i çmimeve), e asaj sekondare si dhe e masave tjera diskriminuese të politikës ekonomike.

Duhet cekur, se një situatë e tillë nuk ishte në republikat tjera të Jugosllavisë. Shkalla relative e ngarkimit të ekonomisë së Kosovës ishte për 4.5 herë më e lartë se ajo e Jugosllavisë, për 3.1 herë më e lartë se e Bosnjës e Hercegovinës dhe për 4.7 herë më e lartë se e asaj të Maqedonisë. Nga e tërë kjo që u tha më lartë duhet thënë se këtu e ka thelbin e tërë politika ekonomike eksploatoreve serbo-jugosllave ndaj Kosovës, si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në atë të shtypjes kombëtare e shoqërore. Tërë mekanizmi i saj ishte drejtuar në atë mënyrë që të ardhurat e Kosovës të derdhen pamëshirshëm në fondet dhe arkat serbo-jugosllave.

Autori vazhdon duke treguar se ligji i eksploatimit është i tillë që në anën e eksploatorëve grumbullohet pasuria minerare, rritet luksi, jeta e ç frenuar, kriminaliteti dhe forcat e errëta reaksionare të shtypësve, kurse në anën tjetër, në anën e të eksploatorëve shtohet varfëria, vështirësi e nivelit të ulët të jetesës, por edhe rriten e forcohen radhët

²² Çfarë akumulimi realizon ekonomia e Kosovës,

²³ Po aty, 33

revolucionare për vendosjen e marrëdhënieve të drejta²⁴, përfundon analizën autori.

Në vijim, autori shkruan për krizën ekonomike që e kishte përfshirë Jugosllavinë në përgjithësi e Kosovën në veçanti. Në punimin "*Kriza e thellë ekonomike*", trajtohet ekonomia e Jugosllavisë që e kishte përfshirë një krizë e madhe. Kjo krizë kishte pasoja të pariparueshme sidomos për Kosovën. Kriza ekonomike nuk ishte thjesht ekonomike, por këtë shtet të formuar artificialisht e kishte kapur edhe kriza politike. Dihej për shenjat e para të krizës ekonomike thekson autori dhe se shenjat e para të saj ishin falimentimet e shumta të organizatave ekonomike, inflacioni i lartë, borxhet e mëdha, jo likuiditeti i ekonomisë, zvogëlimi i aktivitetit ekonomik, mosrealizimi i planeve, humbjet rekorde, papunësia e madhe, dallimet sociale, ulja e standardit dhe varfërimi i masave të gjera popullore etj. Të gjitha këto dukuri që u manifestonin kishin përfshi Jugosllavin por në Kosovë ishin më të theksuara.

Duhet theksuar se inflacioni më 1982 në Jugosllavi ka qenë 30% ndërsa në muajin korrik të vitit 1986 ishte rritur në 98.8%. Kjo gjendje e rëndë ndikoi dukshëm në marrëdhëniet ndër republikane në Jugosllavi. Ndërsa borxhet e mëdha e bëjnë edhe më të vështirë gjendjen e ekonomisë së Kosovës. Obligimet fikse dhe të garantuara ndaj bankave të botës së jashtme në fund të vitit 1982 ishin 1.4 miliard dollarë, që të llogaritura sipas kursit të atëhershëm 400 dinar për një dollar bënin 560 miliardë dinarë. Në fund të vitit 1987, ekonomia e Kosovës i kishte borxh Bankës Popullore të Jugosllavisë 217.1 milion dollarë, që të llogaritura në dinarë bënin 86.8 miliard dinarë. Pra Kosova gjithsej i kishte borxhe në dollarë 1.6 miliard ose 648.8 miliardë dinarë²⁵.

Këtu duhet cekur edhe një dukuri shumë negative për ekonomin e Kosovës e cila ka të bëjë me eksportin. Shtypi zyrtar bënte me dije se nga tërë eksporti i Kosovës, vetëm 30% binte në firmat eksportuese kosovare, kurse 70% të këtij eksporti bëhej përmes firmave eksportuese me seli jashtë Kosove. Kjo ndryshe mund të thuhet se dollarët e realizuar derdeshin jashtë Kosove. Për të qenë kjo gjendje edhe më e keqe, për shkak të politikës serbomadhe në "Bankkos", kjo bankë, devizat e saja i mbante jashtë Kosove.

²⁴ Po aty,36

²⁵ Kriza e thellë ekonomike, 40

Duhet përmendur edhe një dukuri tejet kolonizuese që e aplikonte pushteti jugosllavë ndaj Kosove, fjala është për kredi të volitshme që siguronte Jugosllavia por duke lidhur marrëveshje me Rusin, siç ishte ajo e datës 2.11.1972, me të cilën “Trepça” obligohej që me çmime shumë të ultë nga ato të tregut botëror të eksportoje 60.000 tonelata plumb dhe 35.000 tonelata zink në vit, në Bashkimin Sovjetik. Po me kësi lloj marrëveshje “Trepça” ishte e obligueshme të eksportonte në Çekoslovakia 6.125 tonelata plumb, 4.025 tonelata zink, 16 tonelata kadmium, 5.8 tonelata argjend në vit.

Nga e tërë kjo që u tha më lartë, Jugosllavia përveç që e bënte eksploatimin e “Trepçës”, në mënyrë të drejtpërdrejt duke i shfrytëzuar lëndët e para nga Kosova, ajo nuk ngurronte ti përdorte edhe metodat e përfitimit. Eksportimet e lëndëve të para që bëheshin nga Kosova nëpër mes të aranzhmaneve tregtare ndërshtetërore ishin një nga shumë mënyrat e eksploatimit serbo-jugosllav të Kosovës. Në anën tjetër për ato lëndë të para ose produkte të ekonomisë së Kosovës për të cilat ekonomia serbo-jugosllave kishin shumë nevojë, Kosovës nuk i lejohej të eksportoje, si psh. energjinë elektrike të kombinatit “Kosova”, xehja e minierës së “Goleshit”, e cila e tëra shkonte në “Magnohromin “ e Kralevsë, produktet e “Ballkanit” të Suharekës²⁶ etj. Në këtë mënyrë këto kolektive erdhën në gjendje kritike ekonomiko-financiare e sidomos për deviza të cilat u janë të nevojshme për importimin e lëndës së parë (“Ballkani”) i Suharekës, për pjesë të ndërrimit dhe për kthimin e borxheve botës së jashtme.

Në punimin “*Humbjet në ekonomi- dukuri të krizës së thellë*”, thuhej se dukuri tjetër e krizës së thellë ekonomike të Kosovës ishin edhe humbjet e mëdha. Një ekonomi nëse ka vetëm një akumulim simbolik, siç ishte ajo e Kosovës, pashmangshëm do të ketë edhe humbje të mëdha. Sipas të dhënave të shtypit zyrtar të vitit 1978, thuhej se në elektro-ekonomi e Kosovës, 17.9% të organizatave të punës, 58.7% të prodhimit të xehes së metaleve me ngjyrë, 42.3% të prodhimit të metaleve me ngjyra- që vetëm këto degë të industrisë përbënin 49% të të hyrave të tërësishme të ekonomisë së Kosovës-punonin pa kurrfarë akumulimi. Nga kjo dukuri dhe shumë të tjera rrjedhin humbjet e mëdha. Në vitin 1982 humbjet e ekonomisë së Kosovës kanë qenë 3.6 miliard dinarë të rinj, të cilat më 1987

²⁶ Po aty, 43

kanë kaluar humbjet në shifrën mbi 8 miliard dinarë të rinj, të cilat do të ishin barrë e rëndë për klasën punëtorë të Kosovës²⁷. Shovinistet serbomëdhenj mundoheshin që këto humbje ti paraqesin si pasojë e ndikimit të faktorëve subjektiv të ekonomisë së Kosovës, duke aluduar kryesisht në angazhimin dhe në punën e pamjaftueshme të punëtorëve kosovarë. Ata mundohen ti ikin të vërtetës se e eksploatojnë Kosovën dhe se kjo gjendje e rëndë është pasojë e këtij eksploatimi, duke ua hedhur fajin të eksploaturve.

Autori i librit, thekson se si pasojë e krizës së thellë të ekonomisë së Kosovës është edhe mosrealizimi i planeve ekonomike në vend. *“Mosrealizimi i planeve –pasojë e krizës”* është analiza e radhës e autorit që thekson se krizat e shumta që kishin kaplura Jugosllavin në përgjithësi e Kosovën në veçanti. Sipas projeksioneve që ishin bë më 1978 ishte e paraparë që zhvillimi i Kosovës të jetë 60% më i shpejt se mesatarja jugosllave, por që në të vërtetë ndodhi të jetë shumë më i ngadalshëm për 52%. Në vitin 1982, vëllimi i realizuar i prodhimit industrial ishte për 3.3% më i ulët se sa ai në vitin 1981, kurse për 10.9% më i ulët nga plani. Po kështu edhe në vitin 1983 prodhimi industrial kishte shënua ngecje të madhe. Në prillin e vitit 1983 krahasuar me prillin e vitit 1982 prodhimi industrial i Kosovës pati rënie të dukshme për 7.3% (ai jugosllav-3.2%)²⁸

Papunësia si dukuri e vazhdueshme në Kosovë trajtohej në punimin *“Papunësia- sëmundje e pashërueshme në shoqërinë jugosllave”*, politika kolonialiste e shoviniste serbomadhe dhe kriza e thellë ekonomike e Kosovës kishte bërë të pamundur zgjidhjen e çështjes së punësimit në Kosovë. Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik dhe të strukturës së rëndë dhe të pavolitshme ekonomike në Kosovë ishin të punësuar një numër shumë i vogël i banorëve të aftë për punë. Nga 1.800.000 banor ose nga 900.000 banor të aftë për punë ishin të punësuar vetëm 200.000 veta, çka do të thotë se vetëm 11.1% të banorëve të Kosovës ishin në marrëdhënie pune. Megjithëse papunësia e madhe e kishte përfshirë Jugosllavinë dhe tërë Evropën²⁹, por kjo e Kosovës zinte vendin e parë.

Për të argumentuar papunësinë në Jugosllavi dhe në Kosovë, po e japim këtë tabelë në bazë të të dhënave të kohës:

²⁷ Humbjet në ekonomi- dukuri të krizës së thellë, 45

²⁸ Mosrealizimi i planeve –pasojë e krizës, 47

²⁹ Papunësia- sëmundje e pashërueshme në shoqërinë jugosllave, 48

Përqindja e banorëve të zënë me punë

Jugosllavia	26.8%
Bosnjë e Hercegovin	21.7%
Kroacia	31.5%
Serbia	26.7%
Maqedonia	24.0%
Mali i Zi	23.7%
Vojvodina	28.6%
Sllovenia	41.6%
Kosova	11.1%

Nga kjo pasqyrë shihet qartë se dallimi më i madh ekzistonte në mes Kosovës dhe të republikave si dhe të mesatares jugosllave. Derisa në Jugosllavi punonte çdo i treti, në Slloveni çdo i dyti, në Kosovë çdo i nënti banorë ishte i punësuar³⁰, thuhej në shkrim.

Një gjë dihej se statistikat zyrtare në Jugosllavi asnjëherë nuk e kanë treguar të vërtetën e papunësisë si në Jugosllavi po ashtu edhe në Kosovë. Në Jugosllavi thuhej se janë të papunë mbi 1 milion veta, kurse në Kosovë thuhej se 110.000 e herë 120.000 mijë veta, por që këto shifra aspak nuk përkonin me realitetin.

Në Kosovë, sipas statistikave, të aftë për punë ishin mbi 900.000 mijë banor dhe se të punësuar ishin, ta zëmë afro 200.000 veta, nga kontingjenti i punës mbesin 700.000 veta të pa punë. Çka do të thotë se 700.000 veta merreshin me bujqësi e dihej se bujqësia ishte më e prapambetura në tërë Evropën³¹. Në Kosovë për çdo vit 36.000 persona të rinj kërkonin punë, kurse në vitin 1982 vetëm 6500 veta ishin punësuar. Kjo tregon se problemi i papunësisë akoma më tepër do të ashpërsohej dhe do të marri përmasa shumë të gjëra. Vendet e punës gjithnjë e më shumë po mbylleshin, sidomos në ndërtimtari, ku kjo degë e ekonomisë së Kosovës për vitin 1987, kishte siguruar punë vetëm 35 për qind të kapaciteteve të saja. Në këto kushte të papunësisë së madhe zgjidhja e këtij problemi social kurrsesi nuk mundte ta fshihet Jugosllavia.

³⁰ Po aty, 49

³¹ Po aty, 51

KURBETI - PLAGË E RËNDË PËR SHQIPTARËT

Një ndër plagët e hapura dhe më e rënda për shqiptarët në ish-Jugosllavi, pa dyshim se ishte kurbeti. Një trajtim të thukët autori i broshurës ia bënë kurbetit në punimin *“Kurbeti- plagë e rëndë për shqiptarët”*. Në plagën e kurbetit më të madhe ndikonte edhe sistemi okupues jugosllavë që në mënyrë sistematike ndikonte që shqiptarët të merrnin rrugën e kurbetit. Jugosllavia me një dinakëri të paparë ia shitëte fuqinë punëtore shqiptare të Kosovës vendeve të Perëndimit. Kjo bëhej edhe me qëllimin që me emigrimin e shqiptarëve jashtë shtetit në një mënyrë të pakësohej numri i papunësisë dhe për ta dobësuar elementin shqiptar në Kosovë.

Ajo , punësimin e shqiptarëve në Perëndim e paraqite si një “të mirë” të madhe të shtetit që i bëhej shqiptarëve. Por, kjo tregti kriminale jugosllave në vendet e Perëndimit për shqiptarët halleshumë të Kosovës nuk kishte kurrfarë të mire. Në vend të kësaj “të mire” ata në dhe të huaj hasin në vuajtje të mëdha fizike e psikike. Shqiptarët e ndarë e të katandisur në katër cepat e botës, pa askënd pranë, bënë një jetë të mundimshme e të rëndë. Këta punonin në vendet më të vështira si në fabrikat kimike ku vendasit nuk hynin assesi, në punët më të rënda fizike dhe gjithashtu edhe pagesat e tyre ishin diskriminuese dhe shfrytëzoheshin pa mëshirë. Ata (shqiptarët), duke mos i ditur rregullat e ndryshme të shtetit ku punonin dhe duke mos e ditur mirë gjuhën e shtetit ku punonin, ata, viheshin në pozita të shfrytëzimit marramendës. Këta shqiptarë të emigruar në Perëndim jetonin në baraka pa kurrfarë kushtesh normale për jetesë³², duke shtuar se kurbetin munden njerëzit vetëm ta mendojnë, por ta përjetosh është një tmerr i vërtet.

Shqiptarët veç që emigronin jashtë Jugosllavisë, ata emigronin edhe brenda saj, siç ndodhte nga një republikë në tjetrën si në Slloveni, Kroaci, Serbi e në vende tjera, e që nuk ishte aspak më e lehtë se ata që dilnin jashtë shtetit. Në çdo qendër si në Beograd, Shkup, Zagreb, Lubjanë e në qytetet tjera të ish- Jugosllavisë ekzistonte “tregu i zi”, i shitjes së fuqisë punëtore shqiptare. Për të gjetur punë, këta ishin të detyruar që herët në mëngjes të dalin në vendin e caktuar, të pajisur me lopata, kazma e shata për të pritur nëse do të gjejnë punë te ndonjë zotëri. E zotëria si në kohën

³² Kurbeti- plagë e rëndë për shqiptarët,56

e skllavërisë vjen dhe e zgjedhë atë më të fuqishmin, më të riun, e për pagat nuk bëhet fjalë, ngase në fund të ditës i jepte krejt pakë duke i gjetur një mijë e një gabime gjatë orarit të punës.

Në ish-Jugosllavi ishte miratuar një plan që sa më shumë shqiptarë të punësohen në vende të ndryshme të Jugosllavisë gjëja se për të zbutur sa më shumë papunësinë në Kosovë, por e vërteta qëndronte diku tjetër ngase në këtë mënyrë me emigrimin e shqiptarëve jashtë Kosove, asimilimi i tyre do të jetë më i shpejt dhe në anën tjetër të bëhej kolonizimi sa më i shpejt me popullsi sllave.

Në Kosovë gjenden 60.000 familje me rreth 420.000 anëtarë që nuk kishin asnjë të punësuar dhe asnjë pëllëmbë tokë të punueshme. Për tu parë se sa ishte gënjeshtër kjo që thoshin pushtetarët se gjoja vetëm 85.000 veta janë të papunë, shifrat e lartcekur dëshmojnë të kundërtën. Në 420.000 banorë të këtyre familjeve, 54% të tyre, ose të shprehura në numër absolut ka 226.800 të aftë për punë e që nuk janë të punësuar. Pra, vetëm të papunë në këto 60.000 familje e tejkalojnë shifrën e shpallur prej 85.000 të papunëve për 2,7 herë më shumë. Nga të dhënat e fundit të gazetës “Rilindja” thuhej se 40.000 familje (me rreth 300.000 anëtarë) që e kishin dike në punë nuk kanë as banesë, as tokë të punueshme. Siç shihet 700.000 banorë në Kosovë nga këto 100.000 familje, ose 44% të tërë popullsisë të Kosovës³³, nuk kanë kurrfarë të ardhurash, ose me të ardhura të pamjaftueshme për një jetë normale,- jetojnë në varfëri e mjerim të plotë.

Humbjet ekonomike- barrë e rëndë për punëtorët

Në punimin “ *Humbjet ekonomike- barrë e rëndë për punëtorët*”, trajtohet varfëria dhe rritja gjithnjë e më e madhe e kostos së jetesës, që ishte bërë fat i masave të gjëra punëtore. Në 255 organizata themelore të punës në Kosovë sa kishte më 1987, çdo e treta organizatë punonte me humbje. Humbjet e mëdha dhe të ardhurat e vogla në mënyrë të drejtpërdrejt përcaktonin nivelin e jetesës së punëtorëve. Humbjet në vitin 1982 për një punëtor të Kosovës kanë qenë 28.360 dinar të rinj, kurse ata të Jugosllavisë 13.862 dinar të rinj. Nga kjo del e dhëna se barra e këtyre humbjeve për punëtorin kosovarë është për dy herë më e rëndë se e atij të ish-Jugosllavisë. Këtë barrë e bënte edhe më të rëndë edhe niveli i të

³³ Po aty, 59

ardhurave personale, i cili gjithashtu ishte në dëme të punëtoreve kosovar. Të ardhurat personale të punëtorit kosovar të ndërtimtarisë janë tri herë më të vogla se mesatarja e këtyre të ardhurave në ish-Jugosllavi.

Në Kosovë kishte një numër të madhe të punëtorëve të cilët kishin të ardhura personale 30.000 e 40.000 dinar të rinj. E nga kjo mund të merret me mend se çfarë niveli të jetesës kishte një familje shumë anëtarëshe me këto të ardhura në këto kohë të ngritjes së madhe e të vazhdueshme të çmimeve e të inflacionit.³⁴ Vetëm për bukë një familje shtatë anëtarësh i duhej të harxhonte hiq më pak se 25.000 dinar të rinj. Pra, këto familje me këto të ardhura mund të siguronin vetëm bukën, kripën dhe varfërinë e asgjë tjetër.

Kushtet e vështira të punës rrezikojnë shëndetin dhe jetën e punëtorëve

Në punimin *“Kushtet e vështira të punës rrezikojnë shëndetin dhe jetën e punëtorëve”*, në pika të shkurtra trajtoheshin vështirësitë në punë tek punëtorët në Kosovë, dhe thuhej se kushtet e punëtorëve janë të rënda dhe tejet të padurueshme në sektorin e ekonomisë. Sidomos, kushtet në miniera ishin shumë të rënda sidomos në minierën e “Trepçës”, të Kombinatit “Kosova”, të Obiliqit, të Minierës së “Goleshit” etj.

Autori i shkrimit, vazhdimisht citon shkrimet në gazetën “Rilindja”, ku thotë se “në minierën e Trepçës” e “Goleshit” muret e tyre janë të pa sigurta dhe në çdo moment paraqesin rrezik që të shemben. Në minierën e “Goleshit” ende punohet vetëm me lopata, pa kurrfarë mekanizmi³⁵. Po kështu ndodhë edhe në minierat anë e këndë Kosovës.

Kushtet e punës janë edhe më të vështira, kur kihen parasysh ndotja e madhe e ambientit ku punojnë. Ta zëmë, se sipas të dhënave të shtypit zyrtar koncentrimi i lejuar i superdioksidit duhet të jetë deri në 150 mikro gram në një metër kub, kurse ai në rrethin e shkrites së Zveçanit ishte mbi 800 herë më shumë. Andaj, edhe vije deri te shkatërrimi e helmimi i organeve të punëtorëve, shkaktohen sëmundje e deformime të ndryshme gjenetike. Nga kjo edhe shtohet invaliditeti i parakohshëm i punëtorëve.

³⁴ Humbjet ekonomike- barrë e rëndë për punëtorët, 64

³⁵ Kushtet e vështira të punës rrezikojnë shëndetin dhe jetën e punëtorëve,65

Propaganda shoviniste e Beogradit nxit urrejtjen në mes punëtorëve

Propaganda serbe nuk ishte e njohur vetëm në vitet e 80 e 90 në Kosovë, po ajo datonte që nga periudhat e hershme historike ndaj shqiptarëve. Nga padrejtësitë dhe dhuna e ushtruar ndaj punëtorëve shqiptarë, ata shpesh ishin të detyruar që të protestonin kundër këtyre dukurive negative që manifestoheshin në Kosovë. Pushtetarët dhe Beogradi nuk rrinin duarkryq dhe çdo protestë e shfrytëzonin që në mes punëtorëve të krijonin urrejtje nacionale. Në punimin "*Propaganda shoviniste e Beogradit nxit urrejtjen në mes punëtorëve*", autori me një njohje brilante të situatës në ish-jugosllavi trajton situatën në mes punëtorëve dhe zgjidhjen e problemeve reale të tyre.

Si pasojë e kësaj propagande ishte urrejtja e punëtorëve serbë e jugosllavë ndaj punëtorit shqiptarë të Kosovës, të cilin e shohnin si konkurrent që e ulëte nivelin e tyre të jetesës. Kundër punëtorit shqiptar të Kosovës (punëtorët tjerë) e ndienin veten pjesëtar të kombit sundues dhe pikërisht për këtë arsye bëheshin vegla të verbra në duart e borgjezisë serbomadhe kundër Kosovës, duke e forcuar më këtë edhe sundimin e saj mbi vetë punëtorin serb e jugosllav. Ata, kishin paragjykime sociale e kombëtare kundrejt punëtorit shqiptar të Kosovës³⁶. Ishte shumë e rëndësishme që të sqaroheshin drejt masat e gjera punonjëse të popujve në Jugosllavi mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi sepse zgjidhja e çështjes së Kosovës ishte edhe çlirim i tyre social, politik e shoqëror, por kjo atij shteti okupues nuk i konvenonte dhe nuk donte t'ia dinte për popullin e shtypur shqiptarë.

Dihej mirëfilli se Kosova në ish Jugosllavi ishte regjioni më i pa zhvilluar, kurse klika kriminale e Beogradit asnjëherë nuk i kurseu fjalët për një zhvillim sa më të shpejt të Kosovës, duke u munduar që me mashtrime e demagogji të paraqes politikën e saj shfrytëzuese si politik të drejt. Pushtetarët e Beogradit, nëpër mbledhje, plenumë, kongrese e tubime të ndryshme aq shumë i përsoseshin fjalët demagogjike sa që kishte edhe aso njerëzish që shumë lehtë binin në kurthet e propagandës serbe.

³⁶ Propaganda shoviniste e Beogradit nxit urrejtjen në mes punëtorëve, 68

Pas viteve të 70-ta, populli shqiptarë në Kosovë u katandisë dukshëm në aspektin ekonomik e mos të flasim në atë të sferës politike.. Niveli i jetesës së tyre gjithnjë e më shumë po keqësohej. Të ardhurat mesatare në mënyrë rapide po zvogëloheshin. Në këtë mënyrë hendeku në mes të Kosovës dhe republikave jugosllave si në thellësi ashtu edhe në gjerësi po rriteshin në përmasa të mëdha duke krijuar plagë të rënda sociale për popullin shqiptarë.

Vullkani i protestës

Pabarazia, shtypja e shfrytëzimi nuk kanë si të mos vërtetohen në disponimin e popullatës shqiptare të Kosovës, e cila gjatë gjithë shekujve kurrë nuk u përkul nga çfarëdo armiku e shtypësi qoftë ai. Kosova nuk kishte vakume historike, andaj edhe as në kohën më të re nuk pajtohej me pozitën e saj robëruese e poshtëruese.

Traditat e larta luftarake e revolucionare, si patriotizmi, trimëria, qëndresa, papërkulshmëria, sakrifica e vetëmohimi për liri e pavarësi gjithmonë kanë qenë vetit dhe karakteristikat më fisnike të popullit tonë të lavdishëm dhe heroik. Gjatë tërë historisë populli shqiptarë qyshe prej Ilirëve tanë të lashtë e të lavdishëm i është dashur të bëjnë luftëra të përgjakshme me pushtues e regjime të ndryshme antishqiptare.

Duhet pranuar hapur se me gjithë papërkulshmërinë dhe qëndresën heroike të popullit tonë, për shkak të armiqve shekullor, ai nuk pati mundësi ti realizojë në mënyrë të plotë aspiratat më të larta të tij. Që nga përfundimi i Luftës Dytë Botërore, populli shqiptarë ngeli nën kthetrat e Serbisë e Jugosllavisë e deri më demonstratat studentore të vitit 1981, e më vonë, asnjëherë nuk u pajtua me asgjë ekzistuese. Terrori, gjenocidi, burgosjet masive, dënimet drakoniane të gjyqeve serbomadhe, persekutimet, shtypja e shfrytëzimi, kurrë nuk kanë mundur ta thyejnë shpirtin patriotik e revolucionar të Kosovës, përkundrazi, këto mjete të dhunës e shfrytëzimit edhe më shumë e kanë ndezur shpirtin kryengritës të tyre³⁷. Historikisht është vërtetua se sado të jenë të mëdha këto forca shtypëse e shfrytëzuese për pozitën e tij robëruese nuk kanë pasur sukses qëllimet e tyre përfundimtare.

³⁷ Vullkani i protestës, 74

Këtë më së miri e kanë dëshmuar demonstratat e pranverës së viti 1981 në Kosovë, në të cilat erdhi në shprehje të plotë shpirti patriotik e revolucionar i masave të gjera popullore. Më 1981, punëtori e fshatari, nxënësi e studenti, intelektual, rinia e Kosovës, të ngjeshur sup më sup me grushtet lart e duarthatë u hodhën në demonstrata.

Punëtori shqiptar, duke e ndier më së rëndi peshën e shtypjes, shfrytëzimit, të padrejtësisë e diskriminimit, vendosmërisht protestoi duke kërkuar bukë, liri e Republikë. Fshatari ynë i varfër, i këputur nga jeta e rëndë, mezi priste ti shtrinte duart e veta të forta punëtorit gjithashtu të shumëvujtur të komunitetit tjetër. Nxënësi e studenti, të paepur për idealet më të larta të popullit tonë, me shpirtin e tyre revolucionar dhe vetëmohues, ashtu siç i ka hije rinisë sonë trime, vendosmërisht u hodhën në demonstrata kundër ushtrisë e policisë serbomadhe, të cilat ishin të armatosura gjerë në dhëmbë. Intelektuali patriot, i cili gjithmonë ka qenë, dhe akoma është ndjekur, burgosur e persekutuar nën regjimin serbomadh, i vetëdijshëm për luftën e domosdoshme për të drejtat e popullit tonë me trimëri ia vuri gjoksin këtyre hordhive fashiste. I papuni i cili në këtë sistem vetadministrues nuk mund të gjejë punë kurrsesi, nuk kishte çfarë të priste më. Duke mos pasur çfarë të humb, sepse përveç prangave e varfërisë asgjë tjetër nuk ka, ai u hodhe me guxim e trimëri në demonstrata për të shprehur mllefin kundër dhunës, shtypjes dhe padrejtësive të ndryshme e të shumta³⁸. Po kështu bënë edhe të gjithë ata të shtresave tjera të varfëra e të shfrytëzuara të popullit shqiptarë të Kosovës.

Të gjitha këto masa të shtypura e të shfrytëzuara, dolën në demonstrata që në mënyrë paqësore të demonstrojnë kundër padrejtësive, autori i trajton në shkrimin "*Vullkani i protestës*". Mirëpo këto manifestime paqësore u shndërruan në përleshje të përgjakshme në mes të demonstruesve duarthatë dhe të policisë e ushtrisë së armatosur gjerë në dhëmbë. Forcat e armatosura serbomëdha filluan të villnin zjarr mbi demonstruesit shqiptarë. Një luftë e ashpër dhe e pabarabartë ishte zhvillua në Kosovë. Por, shqiptarët ishin në tokën e tyre, luftonin për drejtësi dhe nuk zbrapseshin nga zjarri vdekjeprurës. Askush nuk dorëzohej por kishin vendosur të qëndronin deri në fund, deri në fitore.

³⁸ Po aty, 75

Përfundimi

Në fund të broshurës, autori në pika të shkurtra jep arsyet, shkaqet dhe pasojat e zhvillimit të dobët ekonomik të Kosovës, duke pasur parasysh shfrytëzimin ekonomik të Kosovës nga ana e Serbisë e Jugosllavisë. Po ashtu në pika të shkurtra jepë edhe propozimet e duhura si me dal nga kjo krizë:

- Të ndërpritet politika antishqiptare serbomadhe;
- Të ndërpritet eksploatimi i njeriut ndaj njeriut si dhe në mes popujve sllavë dhe popullit shqiptarë;
- Të zhduken pabarazitë sociale në mes të Kosovës e Jugosllavisë;
- Të hiqet dorë nga lakmitë grabitëçare dhe nga politika kolonialiste jugosllave-serbomadhe ndaj Kosovës;
- Të ndryshohet strategjia ekonomike e Jugosllavisë ndaj ekonomisë së Kosovës;
- Të jetë në gjendje Kosova krejtësisht në mënyrë të pavarur ti bie planet afatmesme të zhvillimit shoqëror;
- Të ndryshoj rrënjësisht struktura e rëndë ekonomike e cila ekziston;
- Të rritet vëllimi dhe të ndryshojë struktura e tanishme e investimeve të përgjithshme;
- Të zhduket karakteri eksploatues i fondit federativ ndaj Kosovës;
- Ekonomia e Kosovës të jetë në gjendje që ta ketë në disponim tërë akumulimin e mundshëm të saj;
- Të zhduken krizat e thella ekonomike të cilat më së shumti rendojnë mbi masat popullore shqiptare në Kosovë;
- Të ndalet ngritja e vazhdueshme e çmimeve dhe të frenohet inflacioni i lartë;
- Të zhduken problemet e papunësisë së madhe të shqiptarëve të Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare në Jugosllavi;
- Të zhduken shkaqet e varfërisë dhe të mjerimit të madh të punonjësve;
- Pra, kur populli shqiptarë të jetë në gjendje të vendosë për fatin e pasurive natyrore të Kosovës dhe në përgjithësi për fatin e tij, kur të ndërprehet shfrytëzimi i egër shovinist ndaj Kosovës dhe shumë padrejtësi të tjera.

Zgjidhja e vetme dhe e plotë e eksploatimit të Kosovës konsiston në plotësimin e kërkesave të popullit tonë të shprehur nëpërmjet demonstratave dhe revoltave gjatë vitit 1981³⁹.

Populli ynë, i mësuar nga jeta, nuk ka iluzione se do të zhduket shtypja e shfrytëzimi që rëndon mbi të vetëm me premtime të kota dhe demagogji të shovinistëve, përkundrazi ai është i bindur se vetëm me luftë të vendosur do të mbrohen interesat më imanente të tij.

© Pashtriku.org, shkurt 2021

³⁹ Përfundimi, 76-77